



SHT 2021



TITUJT

Editorial: Local elections [faqja 1](#)

Përgjigja ndaj COVID-19 dhe aktivitetet tjera të OKB-së [faqet 2 & 3](#)

Në fokus Përsheptimi i eliminimit të kancerit në qafën e mitrës si problem i shëndetit publik [faqja 4](#)

Në fokus Youth4Climate [faqja 4](#)

EDITORIAL Koordinator i përhershëm i OKB-së

Zgjedhjet e shënojnë kohën e premtimeve të reja. Partitë politike në pushtet i përmbledhin sukseset e tyre, ndërsa kundërshtarët e tyre përqendrohen në dobësitë e tyre. Të gjithë bëjnë premtime, që nëse iu jepet mundësia në periudhën në vijim, ata do të bëjnë më mirë dhe më shumë për qytetarët.

Zgjedhjet janë gjithashtu një mundësi për reflektim. Përpara zgjedhjeve lokale në veçanti, qytetarët mendojnë për përfitimet e komunitetit të tyre dhe i valorizojnë premtimet dhe rezultatet në raport me përbushjen e nevojave të tyre të përditshme. A jam i sigurt në lagjen time? A ka shumë zhurmë? A grumbullohen mbeturinat e mia në kohë? A kam ndonjë park aty pranë? A janë sanksionuar shkeljet në mënyrë të barabartë? Ku mund sigurt të ngas biçikletën time?

Duke i dëgjuar premtimet e reja, qytetarët dhe komunitetet reflektojnë mbi përvojën e tyre me pushtetet e kaluara dhe i bëjnë zgjedhjet e tyre bazuar në dy pyetje kryesore: Çfarë ka për mua? A mund t'i besoj ofertës së ndonjërit prej kandidatëve? Mosbesimi, që rezultojnë në një vendim për të mos votuar është rezultati më i keq i mundshëm. Sa më shumë që qytetarët abstenojnë, aq më pak ka të ngjarë që autoritetet lokale t'i përfaqësojnë nevojat e tyre dhe të rrezikohet llogaridhënia e tyre. Në këtë mënyrë ndahet përgjegjësia: pra, qytetarët duhet të këmbëngulin fuqishëm dhe zëshëm për të drejtat dhe përzgjedhjet e tyre; ndërsa politikanët duhet të dëgjojnë, ofrojnë dhe informojnë.

Maqedonia e Veriut e ka nënshkruar në 2015 Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe që nga ajo kohë shumë herë e ka riafirmuar angazhimin për zbatimin e saj. Mirëpo Agjenda 2030 është kryesisht një angazhim ndaj njerëzve dhe mund të nxitet vetëm nëse zbatohet në nivel lokal. Zhvillimi lokal është vendi ku Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ-të) bëhen personale dhe praktike. Për shembull, mes tjerash, OZhQ 3 (Shëndeti) përkthehet në mbajtjen e niveleve të ndotjes dhe zhurmës në komunitet brenda kufijve, OZhQ 5 (Barazia gjinore) do të thotë se aty pranë ka një kopsht fëmijësh plotësisht funksional, në mënyrë që prindërit të kthehen në punë më herët; OZhQ 11 (Qytetet e qëndrueshme) do të thotë udhëtim i sigurt dhe i shpejtë në punë, OZhQ 16 (Qeverisje e mirë) përkthehet në mbrojtje efektive nga zjarret/përmbytjet/tërmetet.

Zhvillimi i qëndrueshëm nuk është një përmbledhje e thjeshtë

prej 17 OZhQ-ve, por një enigmë e plotë dhe një mjet që udhëheq rrugën e zhvillimit të vendit, nga poshtë-lart. Faktorët që ndikojnë më së shumti në zhvillimin e qëndrueshëm në nivel lokal janë kapaciteti institucional dhe një mjedis që mundëson angazhimin aktiv të rrjeteve të komunitetit dhe kampionëve nga sektori publik dhe privat, si dhe nga shoqëria civile.



Prandaj zgjedhjet gjithashtu paraqesin një mundësi, një shans unik për të ndërtuar partneritet midis autoriteteve lokale dhe qytetarëve për t'i ndjekur së bashku qëllimet e qëndrueshme, që ne të gjithë i ndajmë. Pas disa vitesh në vend, është e qartë se nevojat e njerëzve në Maqedoninë e Veriut nuk ndryshojnë nga askund në botë - ata duan ligj dhe rend dhe duan mjedis të sigurt, të pastër dhe të gjelbër. Duket e thjeshtë, por kërkon një qasje të gjerë dhe të integruar, partneritet të fortë dhe transparencë të plotë.

Shijoni këtë mundësi - votoni për zhvillim të qëndrueshëm! Filloni duke përkthyer qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm në manifestet e partisë, zgjidhni ata që mendojnë se do të japin më të mirën dhe ndihmojni ata ta bëjnë këtë. Si gjithmonë, familja e OKB-së qëndron fort pranë jush për t'ju mbështetur në këtë proces.

Rossana Duxhak
Koordinator i Përhershëm i OKB-së në Maqedoninë e Veriut

DATAT KYÇE

GUSHT

12 Dita Ndërkombëtare e Rinisë u shënuar nga disa agjenci të OKB-së.

19 Dita Botërore Humanitare u festua nën temën #RacaNjerëzore (#TheHumanRace) dhe u fokusua në veprimet klimatike

23-26 Qendra e ligjit për refugjatët dhe migracionin në kuadër të Fakultetit Juridik "Justinian Prima", Universiteti "Shën. Qirili dhe Metodi" në Shkup, në partneritet me Përfaqësuesin e UNHCR-së në Maqedoninë e Veriut dhe në bashkëpunim me Institutin Ndërkombëtar të së Drejtës Humanitare - Sanremo, Itali do të jetë nikoqir i edicionit të dytë të [Shkolles Verore për Refugjatët dhe Migracionin](#)

SHTATOR

7 UNHCR-ja mbajti një trajnim në internet mbi Integrimin dhe përfshirjen socio-ekonomike për partnerët kryesorë që punojnë në integrimin lokal

PËRGGJIGJA NDAJ KOVID-19 DHE AKTIVITETET TJERA TË OKB-SË

Agjencitë e OKB-së vazhdojnë t'i mbështesin ndërhyrjet për rikuperimin efektiv nga KOVID-19 në lidhje me çështjet brenda fushave të tyre përkatëse të ekspertizës.

UNICEF-i vazhdon ta promovojë qëndrimin se rihapja e shkollave nuk mund të presë dhe po punon me partnerët për të siguruar që të gjithë fëmijët të kthehen në klasa të sigurt që nga fillimi dhe gjatë gjithë vitit shkollor. Maqedonia e Veriut regjistroi mbylljen më të gjatë të shkollave gjatë pandemisë KOVID19, me nxënës që e ndoqën mësimin pa prezencë fizike për 54 javë në total.

Në përgatitjet për rihapjen e shkollave, pesëmbëdhjetë **shkolla të identifikuar nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit morën stacione lëvizëse për larjen e duarve për t'i përmirësuar kapacitetet e tyre për ujë, kanalizime dhe higjienë**, të dhuruara nga UNICEF-i dhe USAID-i.

UNICEF-i e mbështeti krijimin e platformës së parë nacionale për tekstet shkollore interaktive digjitale. E titulluar E-Library, kjo platformë është pjesë e zgjerimit dhe azhurnimit të vazhdueshëm të nismës Eduino. Aktualisht Biblioteka elektronike ofron tekste interaktive digjitale për nxënësit e klasës IV në 5 gjuhë lokale. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit janë pronarë të platformës dhe i ruajnë të drejtat për të gjitha tekstet shkollore që tani janë në dispozicion. Vizioni afatgjatë është që Biblioteka elektronike të bëhet një pikë qendrore për të gjithë materialin mësimor digjital, duke përfshirë librat shkollore, fletoret e punës, audio narracionet, e tjera, duke i vënë të gjitha ato në dispozicion falas për të gjithë nxënësit. Aplikacioni online i platformës plotësohet me aplikacione Android dhe Windows, të cilat i lejojnë nxënësit të kenë qasje në tekstet interaktive digjitale edhe në komunitetet me lidhje të pamjaftueshëm të internetit. Ministria e ka mbështetur më tej këtë nismë, duke blerë 30.000 tableta Android për fëmijët pa kompjuter dhe/ose lidhje interneti në shtëpi.

OBSH-ja në Maqedoninë e Veriut filloi me zbatimin e aktiviteteve të ndërlidhura me komunitetin për ngritjen e vetëdijes për vaksinimin kundër KOVID-19 dhe masat mbrojtëse që kanë në fokus punonjësit e kujdesit shëndetësor, të moshuarit dhe popullatën rome. Veçanërisht aktivitetet për promovimin e sjelljeve të sigurta u përqendruan në fushat e mëposhtme: udhëtimet dhe turizmi, jeta jashtë ambienteve të shtëpisë (tubimet shoqërore, festivalet, dasmat) dhe rihapja e shkollave. Dr Xhahane Tavila, Përfaqësuese e OBSH-së në Maqedoninë e Veriut mbajti një fjalim kryesor në Konferencën e gjashtëmbëdhjetë vjetore ndërkombëtare mbi integrimin evropian në temën "Qëndrueshmëria në Evropë pas pandemisë - AICEI2021" të mbajtur praktikisht më 16 shtator 2021, organizuar nga Universiteti Kolegji Amerikan në Shkup. Dr. Tavila e theksoi rëndësinë e ndërtimit më të mirë dhe vendosjen e shëndetit në epiqendër të shoqërisë.

Në kuadër të projektit të buxhetimit me ndjeshmëri gjinore të Kombeve të Bashkuara, Finance Think përfundoi 5 vlerësime të buxhetit gjinor që japin një pasqyrë iniciativave gjinore të ndërmarra nga komunat e Gjoçe Petrovit, Koçanit, Strumicës, Sveti Nikollës dhe Velesit në lidhje me zbutjen e efekteve të KOVID-19 për gratë dhe burrat. **Vlerësimet** përfshijnë rekomandime të politikave dhe buxhetit për komunat në krijimin e programeve dhe buxheteve vendore për t'u përgjigjur më mirë nevojave post-emergjencës në lidhje KOVID-19.

Aktivitetet tjera të OKB-së

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë - UNFPA filloi me zbatimin e projektit "Parandalimi dhe mbrojtja kundër dhunës me bazë gjinore në Maqedoninë e Veriut", financuar nga Ambasada Britanike në Shkup. Projekti do ta mbështesë Qeverinë e Maqedonisë së Veriut për të përfshirë dhe zbatuar politikë të integruara anekënd vendit mbi dhunën me bazë gjinore

(DhBGj), në përputhje me parimet e Konventës së Stambollit (KS). Ai do të mbështesë zbatimin e KS-së përmes një kuadri të fortë ligjor dhe politikash multisektoriale dhe me të dhëna të përforuara, që e adresojnë përfshirjen e dhunësve dhe ndikojnë në media, në mënyrë që gratë dhe vajzat të jenë të lira nga të gjitha format e dhunës dhe kërcënimi i një dhune të tillë.

UNFPA-ja vazhdon t'i mbështesë përpjekjet nacionale në fushën e përmirësimit të rezultateve shëndetësore të nënave dhe të sapolindurve. Në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Komitetin e nënës së sigurt, siç ishte parashikuar në kuadër të Master planit nacional të kujdesit

dhe arteve në festivalin muzikor "Zdravo Mladi" (Tungjatjeta të rinj).

UNICEF-i e mbështet zhvillimin e Strategjisë Nacionale për Drejtësinë për Fëmijët në Republikën e Maqedonisë së Veriut [2022-2026] dhe Planin e Veprimit [2022-2023]. Strategjia është duke u zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Shtetëror për Parandalimin e Delikencës së Fëmijëve, me mbështetjen e ekspertëve ndërkombëtarë, përmes një serie punëtorish dhe konsultimesh, dhe do të miratohet deri në fund të vitit 2021. Aktivitetet janë pjesë e financuar nga BE-ja, me kofinancim nga UNICEF-i në kuadër të projektit "Drejtësia



ECO programme on CINEDAYS film festival was organised to promote activities on the importance of protecting our environment

perinatal 2020 dhe Planit shoqëruar për implementim, UNFPA-ja e organizoi raundin e parë të trajnimeve për gjinekologë/obstetër dhe mami në fushën e kujdesit efektiv perinatal, për entet e nivelit të parë. 35 pjesëmarrës nga spitalet e përgjithshme në Gostivar, Prilep, Strugë, Ohër dhe Kërçovë i ndoqën trajnimet e mbajtura nga trajnerë të certifikuar nga Klinika Universitare për Gjinekologji dhe Obstetrikë, të cilët gjithashtu ishin të trajnuar nga UNFPA-ja.

Në rajonin e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore (ELAQ) kanceri i qafës së mitrës është një nga shkaqet kryesore të vdekshmërisë tek gratë në moshë riprodhuese. Si përgjigje ndaj kësaj dukurie dhe si pjesë e një ndërhyrjeje rajonale të UNFPA-së në ELAQ, UNFPA-ja në Maqedoninë e Veriut e realizoi një vlerësim nacional të kapaciteteve të vendit dhe gatishmërisë për zbatim të Strategjisë Globale të OBSH-së për ta përshpejtuar eliminimin e kancerit të qafës së mitrës, i cili u lëshua në vitin 2020. Bazuar në këtë vlerësim, në periudhën e ardhshme do të identifikohen prioritetet e vendit, si dhe mbështetja e ardhshme nga UNFPA për Maqedoninë e Veriut në këtë fushë.

UNICEF e nisi platformën **U-Report** si një mekanizëm për t'i fuqizuar të rinjtë që ta ndajnë mendimin e tyre mbi çështjet, për të cilat interesohen dhe të bëhen faktorë pozitivë të ndryshimit në komunitetet e tyre. Raporti u prezantua në një **eveniment** konsultativ në parkun e qytetit në Shkup, së bashku me të rinjtë, vendimmarrësit, organizatat ndërkombëtare dhe ekspertët.

Në një punëtorë të realizuar në internet për të mendur në drejtim të projektimit, pesë ekupeve të të rinjve të moshës 13-19 vjeçare iu dhanë nga 120.000 denarë për ta realizuar zgjidhjen e tyre inovative për zvogëlimin e efekteve të dëmshme të ndryshimit të klimës dhe mbrojtjen e mjedisit.

Për herë të parë në **20 vitet e festivalit të filmit CINEDAYS, UNICEF-i dhe partnerët së bashku me Qendrën Kulturore Rinore e hartuan një EKO program** për t'i promovuar aktivitetet mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit natyror dhe reagimit ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo përfshinte shfaqjen e filmit dokumentar "Unë jam Greta" në festivalin e filmit Makedox, si dhe ngritjen e vetëdijes mjedisore të të rinjtë përmes muzikës

për Fëmijët - BE-ja për drejtësinë e të miturve dhe fëmijëve". Qëllimi është të lehtësohet qasja (e fëmijëve) në sistemin e drejtësisë, që është i ndjeshëm ndaj fëmijëve, ndaj gjinisë dhe i pajisur mirë, i cili njëkohësisht bazohet në një kuadër ligjor nacional gjithëpërfshirës dhe bashkëpunim ndërshtetëror midis drejtësisë për fëmijët, mirëqenies sociale, shëndetit dhe/ose enteve arsimore.

Më 24-25 korrik 2021, **IOM-i** në Maqedoninë e Veriut organizoi një punëtorë në Shkup për fuqizimin e rrjeteve të prindërve nga nëntë komunitete të ndryshme në vend. IOM-i do të punojë me aktorët vendas për të siguruar që këto grupe të bëhen formale dhe të afta të veprojnë si një nga praktikuesit e vijës së parë në ndërtimin e qëndrueshmërisë midis prindërve dhe të rinjve.

Gjithashtu, gjatë muajit korrik në Plasnice u organizua një punëtorë e edukimit mbi punën e mediave. Përmes këtyre punëtorëve të rinjtë mësohen të bëhen konsumatorë kritikë të mediave, lajmeve dhe informacioneve. Fokus i këtyre seminareve do të vazhdojë të jetë në parimet e gazetarisë objektive, kritikën e burimeve dhe strategjitë e manipulimit të mediave që i aftësojnë pjesëmarrësit të marrin dhe ndajnë informacione në mënyrë kritike, me vetëdije dhe me përgjegjësi.

Me mbështetjen e **Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, UNICEF-i, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe partnerët i hapën dy Qendrat e para mbështetëse për familjet kujdestare** në vend, me qëllim që ta promovojnë kujdesin me bazë familjare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe për të siguruar mbështetje për kujdestarët e rinj dhe familjet ekzistuese. UNICEF-i kontribuoi në sistemin e përkujdesjes përmes ndihmës teknike për standardet e kujdestarisë, procedurat, mjetet, materialet e trajnimit dhe modulet e specializuara për profesionistët, si dhe rinovimin e objekteve dhe pajisjeve të prokurimit për Shkupin.

UNHCR dhe **UNDP** po e pilotojnë një vegël të zhvilluar bashkërisht, që buron nga OZHQ-të në lidhje me zhvendosjet e detyrueshme dhe pashtetësinë në Maqedoninë e Veriut. Ky mekanizëm mund të jetë i dobishëm në avancimin e qëllimeve strategjike të të dy organizatave. Kjo vegël siguron një kornizë dhe strukturë të mirë dhe fleksibile/të adaptueshme për ta rritur

AKTIVITETET TJERA TË OKB-SË

bashkëpunimin e agjencive dhe për ta zgjeruar angazhimin e shumë palëve në çështjet me interes të përbashkët.

Me një sesion fillestar UNHCR-ja e prezantoi ekipin e sapoformuar për Mbikëqyrje të jashtme. Iniciativa e këtillë e bashkon një ekip artistësh, aktivistësh, intelektualësh dhe ndikuesish për ta eksperimentuar, sjellë një perspektivë të re të veprimit dhe për ta fuqizuar avokimin dhe mbështetjen brenda fushëveprimit të mandatit të UNHCR-së.

Më 26 gusht [UNDP dhe Qeveria Gjermane i dhuruan pajisje kompjuterike](#) Ministrisë së Punëve të Brendshme për të



New Community Works Programme was launched in 56 municipalities engaging 500 unemployed people as social service providers

mundësuar kontroll më efektiv të Armëve të Vogla dhe të Lehta (ALV/SALW). Dhurimi është bërë si pjesë e projektit "Përmirësimi i Praktikave Nacionale për Kontrollin e AVL-ve dhe Ndërtimi i Komuniteteve të Qëndrueshme", objektivi kryesor i të cilit është zvogëlimi i keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta, si një nga shkaqet më të zakonshme të incidenteve të armatosura në vend. Dhurimi i kësaj pajisje përfaqëson vetëm një segment të projektit të përgjithshëm, i cili do të përmirësojë sistemin e informacionit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe për më tepër, përmes zhvillimit dhe zbatimit të Sistemit të Informacioneve të Policisë, do ta sigurojë digjitalizimin dhe përmirësimin e proceseve operacionale dhe do të përshpejtojë shkëmbimin e informacioneve institucionale.

Më 20 shtator, [u nis zyrtarisht projekt ReLOaD2](#), i UNDP-së. Kjo është faza e dytë e projektit, qëllimi kryesor i së cilës është forcimi i partneritetit midis komunave dhe organizatave të shoqërisë civile përmes ndarjes transparente të fondeve të destinuara për aktivitetet e projektit që do të ofrojnë përfitim për qytetarët e vendit. ReLOaD2 do të zbatohet në periudhën 2021-2024 në tetë komuna partnere: Kumanovë, Gostivar, Manastir, Ohër, Veles, Gjevgjeli, Koçanë dhe Kriva Pallankë. Aktivitetet e projektit përfshijnë trajnime për punonjësit në komuna, mbështetje të projekteve të interesit publik, të aplikuara nga organizatat e shoqërisë civile, si dhe trajnime për OShC-të për t'i forcuar kapacitetet e tyre përgjatore të projekteve. ReLOaD2 mbështetet financiarisht nga Bashkimi Evropian.

[UNDP dhe Ministria e Financave e prezantuan](#) luftën e përbashkët kundër ekonomisë joformale në vend si pjesë e Projektit "Reforma në Menaxhimin e Financave Publike". Aktivitetet kryesore do të fokusohen në njohjen dhe zvogëlimin e ekonomisë gri duke hartuar saktësisht sektorët, ku ajo është më e përhapur dhe duke identifikuar shkaqet kryesore të shtafjes së saj. Ekipi i UNDP-së është i përkushtuar fuqishëm për t'i mbështetur përpjekjet e Qeverisë për ta transformuar sistemin nacional të menaxhimit të financave publike dhe për të krijuar një mjedis të favorshëm biznesi, që do të shpinte në një rënie të ekonomisë joformale. Projekti zbatohet me mbështetjen financiare dhe eksperte të Ministrisë së Financave të Republikës së Sllovakisë.

[UNDP i inicioi pilot masat inovative](#) në suaza të Planit operacional të masave aktive të tregut të punës. Rreth 210 personave të papunë, që do t'i nënshtrohen programit të trajnimit dhe do të bëhen ofrues të licencuar të shërbimeve, do t'u ofrohet vend pune në disa nga OShC/Ofruesit e Shërbimeve ekzistues, që janë të gatshëm për ta zgjeruar fushëveprimin e tyre ose do t'u ofrohet një mundësi për t'i bashkuar forcat dhe për ta krijuar entitetin e tyre të biznesit.

UNDP nisi ciklin e ri vjetor të Programit të punëve në komunitet me përzgjedhjen e 56 komunave dhe angazhimin e 500 personave të papunë, si ofrues të shërbimeve sociale, që ofrojnë

shërbime të tilla për grupe të ndryshme të cenueshme, siç janë romët, njerëzit dhe fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit nga bashkësitë lokale.

Në kuadër të mbështetjes së negociatave të pranimit në BE, organizatat e **UNOPS**-it bëjnë një trajnim mbi "Bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjen penale" për përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë dhe Sekretariatit për Çështjet Evropiane të fokusuar në ligjin e sapo miratuar për bashkëpunim në çështjet penale dhe implikimet e tij në qasjen në drejtësi efektive dhe efektive, si dhe ndikimi i dokumenteve dhe gjykatave ndërkombëtare në sistemin e drejtësisë. Përveç kësaj është organizuar një raund tjetër trajnimit për personelin e Avokatit të Popullit mbi parimet dhe teknikat e drejtimit të hetimeve dhe kryerjen e ekzaminimeve efektive në pajtim me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare.

Një deklaratë e mbështetjes për Studimin e Valorizimit të Liqenit të Ohrit [u nënshkrua](#) nga komunat e Ohrit më 22 shtator, në kuadër të projektit GEF/**UNEP** STAR5. Ceremonia e përfshiu edhe dorëzimin zyrtar nga MMJPH-ja të dokumenteve të pranimit të lokacioneve me status Ramsar në komunat e Ohrit, Strugës dhe Debrcës.

Përfaqësuesit e Entit Shtetëror të Statistikës, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale morën pjesë në eventin rajonal të organizuar nga UN Women për përfshirjen e gjinisë në menaxhimin e financave publike dhe rolin e Sistemeve të menaxhimit të integruar financiar, që u zhvillua në Tiranë, Shqipëri (7-8 shtator 2021). Gjatë këtij eventimi u prezantua progresi në zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Maqedoninë e Veriut dhe proceset e vazhdueshme për avancimin e kornizës ligjore dhe institucionale për rritjen e barazisë gjinore, e mbështetur financiarisht nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar - Sida dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

Përfaqësuesit e komunave të Karposhit, Makedonska Kamenicës, Viniçës, Çashkës, Dellçevës, Kavadarit, Makedonski Brodit i zgjeruan njohuritë dhe aftësitë e tyre në krijimin e programeve dhe buxheteve me ndjeshmëri gjinore, përmes analizimit të të

dhënave dhe informacioneve nga perspektiva gjinore gjatë një punëtorie tre-ditore (15-17 shtator 2021) të organizuar nga UN Women.

Në kuadër të programit rajonal të UN Women "Zbatimi i normave, ndryshimi i mendjes", financuar nga Bashkimi Evropian, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Maqedoninë e Veriut e organizoi një event me temën "Si të forcohet roli i shoqërisë civile në zbatimin e Konventës së Stambollit?" (13 shtator). Në ngjarjen e mbajtur më 13 shtator, pjesëmarrësit e diskutuan projekt raportin e parë në hije për GREVIO, të përgatitur nga nëntë OShC-të anëtarë të Platformës për Barazi Gjinore.

Drejtoresha Rajonale e Kombeve të Bashkuara për Evropën dhe Azinë Qendrore Alia El-Jasir dhe Udhëheqësja e Zyrës, Vesna Ivanovikj-Castarede mbajtën fjalime në konferencën e mbajtur në Shkup (14-15 shtator) "Gratë në politikën e jashtme", të organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme. Gjatë misionit të saj në Maqedoninë e Veriut, Drejtoresha Rajonale Alia El-Jasir i diskutoi qasjet strategjike për fuqizimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe avancimin e barazisë gjinore me institucionet partnere në vend të UN Women Shkup. Kjo përfshiu diskutime mbi forcimin e rolit të Entit Shtetëror të Statistikës në avancimin e aplikimit të buxhetimit të përgjegjshëm ndaj gjinisë dhe krijimin e Qendrës së parë burimore për buxhetin me ndjeshmëri gjinore në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale.

UNHCR-ja, së bashku me Shoqatën e Juristëve të Rinj të Maqedonisë së Veriut (MYLA) dhe Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë së Veriut (ShGM) i dorëzuan [Çmimet për gazetari 2020](#) për gazetarët të cilët, gjatë vitit të kaluar, kontribuan në spektrin mediatic me rrëfime dhe fotografi profesionale për gjendjen e refugjatëve dhe personave pa shtetësi në Maqedoninë e Veriut. Ky aktivitet financohet nga Fondi i Mirëbesimit me Shumë Partnerë mbi migracionin.

UNHCR-ja filloi ushtrimin e Vlerësimit Vjetor Pjesëmarrës me personat e interesuar në bashkëpunim me autoritetet dhe organizatat partnere. Ushtrimi përbëhet nga një sërë diskutimesh me refugjatët dhe azilërkuesit, me qëllim që t'i diskutojnë së bashku sfidat me të cilat përballen, t'i kuptojnë kapacitetet e tyre dhe t'i dëgjojnë zgjidhjet e tyre për tejkalimin e sfidave. Gjetjet e diskutimeve do të përdoren për të formësuar plane, strategji dhe ndërhyrje të mëtejshme, duke siguruar që pikëpamjet e refugjatëve dhe azilërkuesve të pasqyrohen në mënyrë adekuate.

Në përputhje me prioritetet e UNHCR-së për të investuar në rininë dhe arsimin, UNHCR për Maqedoninë e Veriut [nënshkroi](#) një Memorandum Mirëkuptimi me Universitetin "Goce Delçev" nga Shtipi. Memorandumi bazohet në marrëdhëniet tashmë të mira të krijuara midis palëve, duke përfshirë pjesëmarrjen në [Konferencën ndërkombëtare](#) për transferime dhe bashkëpunim me vendet e treta: Dekonstruktimi i projektit formal dhe joformal në politikën e migrimit dhe azilit (MAPS).

Më 15-16 shtator 2021, IOM-i e organizoi në Beograd takimin e parë rajonal mbi Alternativat e ndalimit të imigrantëve në Ballkanin Perëndimor. Takimi rajonal e ngriti ndërgjegjësimin mbi përfitimet dhe praktikën më të mira mbi Alternativat e ndalimit (paraburgimit) nga autoritetet e Ballkanin Perëndimor dhe nisi diskutimet për zhvillimin e alternativave të tilla pilote në rajon. Bazuar në këtë takim fillestar, IOM-i do të punojë me autoritetet nacionale në Ballkanin Perëndimor për të zhvilluar pilotë alternativa të qëndrueshme në të ardhmen dhe për të siguruar që të drejtat e imigrantëve të respektohen, mbrohen dhe përmbushen, në përputhje me Objektivin 13 të Marrëveshjes Globale mbi Migracionin (GCM): Përdorimi i ndalimit (paraburgimit) në kontekstin e imigrimit duhet të jetë si masë dhe zgjidhje e fundit dhe njëkohësisht të punohet drejt zgjidhjeve alternative.

Në Fokus Përshpejtimi i eliminimit të kancerit në qafën e mitrës si problem i shëndetit publik

Në rrafshin global për çdo vit regjistrohen më shumë se 570,000 raste të reja të kancerit të qafës së mitrës dhe 311,000 vdekje nga kjo sëmundje, madje këto shifra parashikohet të rriten në më shumë se 700,000 raste të reja dhe 400,000 vdekje në vit deri në vitin 2030. Pjesa dërrmuese e këtyre rasteve dhe vdekjeve të reja ndodhin në mesin e grave në gjendje të pafavorshme, që jetojnë në vendet me të ardhura të ulëta, me të ardhura mesatare të ulëta dhe të mesme, të cilave në përgjithësi u mungojnë programet efektive të parandalimit të kancerit të qafës së mitrës - vaksinimi HPV dhe ekzaminimi i qafës së mitrës - që janë të zakonshme në vendet me të ardhura të larta (shih Ilustrimin 1).

Ekzistojnë metoda të provuara, me kosto efektive për ta eliminuar kancerin e qafës së mitrës, por ende nuk janë zbatuar gjerësisht në vendet ku barra e sëmundjes është më e lartë. Në maj të vitit 2020, Asambleja Botërore e Shëndetësisë e miratoi Strategjinë globale për ta përshpejtuar eliminimin e kancerit të qafës së mitrës si një problem i shëndetit publik, me synimin që të gjitha vendet të arrijnë një shkallë të incidencës nën 4 për 100,000 gra. Strategjia fokusohet në tre shtylla kryesore të veprimit:

- ◊ Parandalimi përmes vaksinimit
- ◊ Ekzaminimi i qafës së mitrës dhe mjekimi i lezimeve (plagëve) parakanceroze
- ◊ Trajtimi dhe kujdesi paliativ për kancerin invaziv të qafës së mitrës

Po ashtu rekomandohet një pako e synimeve, të njohura si synimet 90-70-90, për t'u përbushur deri në vitin 2030:

- ◊ 90% e vajzave të vaksinuara plotësisht kundër HPV-së deri në moshën 15 vjeçare;
- ◊ 70% e grave të ekzaminuara me një test të performancës së lartë deri në moshën 35 vjeçare dhe përsëri në moshën 45 vjeçare;
- ◊ 90% e grave të identifikuar që janë mjekuar për sëmundjen e qafës së mitrës, duke përfshirë;
- ◊ 90% e grave me mjekim para kancerit.
- ◊ 90% e grave me kancer invaziv të menaxhuar.

Kanceri i qafës së mitrës në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore


Krahasuar me Evropën Perëndimore, numri i rasteve të reja dhe vdekjeve nga kanceri i qafës së mitrës është deri në 10 herë më i lartë në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (ELAQ), ku sëmundja është shkaku i dytë më i zakonshëm i vdekjeve nga kanceri tek gratë në moshë riprodhuese. Ekziston një dëshmi e qartë se incidenca më e lartë dhe nivelet e vdekshmërisë që shihen aktualisht në rajon janë kryesisht për shkak të mungesës së:

- ◊ Programeve efektive të ekzaminimit të qafës së mitrës (përfshirë trajtimin e të gjitha lezimeve prekanceroze me rëndësi klinike);
- ◊ Programeve të përhapura të vaksinimit kundër HPV-së; dhe
- ◊ Mjekimit të qashtëm, me cilësi të lartë, të kancerit të qafës së mitrës

In North Macedonia, about 150 new cases have been recorded Gjatë viteve të fundit në Maqedoninë e Veriut janë regjistruar rreth 150 raste të reja për çdo vit, ndërsa rreth 60 pacientë vdesin çdo vit për shkak të gjendjes së shkakuar nga kjo sëmundje.

Investime të rëndësishme janë bërë në dekadën e fundit në fushën e parandalimit përmes ekzaminimit dhe dhënies së vaksinës kundër HPV-së. Përqindja e vajzave që kanë marrë dy doza vaksine, të siguruar brenda buxhetit të shtetit ishte 57.8% në

Figure 1: Comparison of national HPV vaccination and cervical screening programme implementation vs cervical cancer incidence and mortality



vitin 2019 dhe 54.7% në vitin 2018.

UNFPA-ja në Maqedonia e Veriut i mbështet homologët nacional në zhvillimin e udhëzimeve, përmirësimin e procesit të shqyrtimit dhe ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve shëndetësorë në përpunje me dëshmitë më të fundit shkencore. Për më tepër, ajo vepron si mbledhës dhe nxit shkëmbimin e njohurive midis profesionistëve të shëndetit, hartuesve të politikave dhe asociacioneve profesionale. Për shkak të diversitetit dhe pabarazive midis vendeve të ELAQ-së në drejtim të kontrollit dhe mjekimit nga

kanceri, medoemos nevojitet një qasje rajonale për ndarjen e burimeve, lehtësimin e bashkëpunimit mes vendeve të jugut dhe rritjen e veprimit të koordinuar midis tyre, me qëllim që të adresohet ky problem në mënyrë më efektive. Në këtë drejtim Zyra rajonale e UNFPA-së për ELAQ e ka iniciuar nisimën për krijimin e një Aleance rajonale ELAQ për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës, përfshirë këtu edhe Maqedoninë e Veriut. Kjo paraqet një aleancë vullnetare të krijuesve të politikave, institucioneve teknike, ekspertëve dhe mjekëve nga të gjitha vendet e rajonit.

Në Fokus Youth4Climate

Pothuajse 400 të rinj nga 186 vende anëtare të Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) iu bashkuan takimit "Youth4Climate-Driving Ambition (TeRinjtePerKlimën - Ambicia shtytëse)" në Milano më 28-30 shtator për t'i elaboruar propozimet konkrete për politikëbërësit e eventimentit para COP26 në Milano. Këto propozime do të çohen përpara në COP26 në Glasgow në muajin nëntor. Takimi në Milano është pjesë e procesit për përfshirjen e të rinjve në procesin e negociatave të OKB -së për klimën.

Maqedonia e Veriut u përfaqësua nga dy delegatë të rinj, Angela Busheska dhe Naser Veliu të cilët i përfaqësojnë pikëpamjet dhe qëndrimet e të rinjve nga ky vend. UNICEF-i në Maqedoninë e Veriut, së bashku me Ambasadat Italiane, Britanike dhe Suedeze e mbështetën Angellën dhe Naserin në përgatitjet e tyre dhe hartuan një proces konsultimi, i cili përfshinte përdorimin e procesit të konsultimit të të rinjve "Rimagjino të ardhmen" për t'i mbledhur pikëpamjet e qindra të rinjve nga Maqedonia e Veriut.

Delegatët e të rinjve u angazhuan në dialog për t'i adresuar çështjet urgjente dhe prioritare të veprimit për klimën duke punuar rreth katër temave: 1) Ambicia shtytëse e të rinjve; 2) Rimëkëmbja e qëndrueshme; 3) Angazhimi i palëve jo-shtetërore; 4) Shoqëria e ndërgjegjshme për klimën. Çdo temë korrespondon me një grup pune i cili udhëhiqej nga dy persona: një përfaqësues i të rinjve dhe një ekspert i lartë nga organizatat ndërkombëtare. Temat kryesore të diskutuara në secilën temë ishin:

1. **Ambicia shtytëse e të rinjve** – fuqizimi i të rinjve për ta

mbajtur një qëndrim dhe për ta vënë në funksion zërin e tyre kolektiv për të bërë një politikë klimatike me fokus të rinjtë në nivelin lokal, nacional dhe ndërkombëtar.

2. **Rimëkëmbja e qëndrueshme** – diskutimet u përqendruan në Tranzicionin e energjisë dhe Punët e Gjelbra: Përshtatja dhe qëndrueshmëria: Zgjidhjet e bazuara në natyrë: Rrjedhat financiare; dhe Turizmin.
3. **Angazhimi i palëve jo-shtetërore** – pesë fushat kryesore të diskutuara përfshijnë: Ushqimin; Sipërmarrësinë; Sportet; Modën; dhe Artet.
4. **Shoqëria e ndërgjegjshme për klimën** - Rrëfimi i tregimeve me ndikim: Arsimi, Mobilizimi publik dhe Mediat janë temat e kësaj kategorie

Pas "Të rinjtë për klimën - Ambicia shtytëse" në Milano dhe përpara COP26 në Glasgow, UNICEF-i në Maqedoninë e Veriut së bashku me ambasadat Italiane, Suedeze dhe Britanike do të mbështesin një "Samit të Rinisë për Klimën" në Shkup, me qëllim që t'i angazhojë të rinjtë deri në zhvillimin e mëtejshëm të deklaratës dhe dialogut së të rinjve me zyrtarët shtetëror lidhur me çështjen e klimës. with national officials.

The latest version of the Sustainable Development Bulletin is available on UN North Macedonia website. For additional information, please contact rc-northmacedonia@un.org. Produced by the UN Resident Coordinator's Office in North Macedonia | 10 June 2021

www.un.mk